



**RAPORTI GJASHTËMUJOR I MAMOGRAFISË MOBILE**  
**PROJEKTI “MA-MO”**



**Nga: Dr.Ardian Biçaku<sup>1,2</sup>**

<sup>1</sup>SHSKUK/QKUK Klinika e Radiologjis, Prishtinë

<sup>2</sup>Koordinator i Mamografisë Mobile në SHSKUK

**Periudha e raportimit: 01 Janar – 30 Qershor, 2015**

**Prill, 2015**

## RAPORTI GJASHTËMUJORË PËR MAMOGRAFINË MOBILE RAPORTI PËR PERIUdhËN GJASHTËMUJORE JANAR-QERSHOR 2015

Deri më 31 Dhjetor 2014 me Mammograf i Mobile janë ekzaminuar 260 pacientë.


Prej 1 Janari deri më 23 Shkurt 2015 për shkak të temperaturave të ulta me mamograf mobil është punuar në hapësirat e QKUK-së dhe kryesisht pacientët e QKUK-së. Gjithashtu, në kuadër të sensibilizimit të popullatës për ekzaminime mamografike janë ekzaminuar në mënyrë të organizuar femrat e organizatave të ndryshme si: të policisë së Kosovës, obduspersonit etj., dhe deri më 23 Shkurt 2015 janë ekzaminuar 130 femra, pa llogaritur 260 femra te ekzaminuara gjate vitit 260.

Me 24 Shkurt Mamografi mobil për herë të parë fillon punën në terren, duke filluar në Komunën e Gjilanit, (përkatësisht në fshatin Zhegër, pastaj Dobercan, Perlepnice dhe Gjilan), Komunën e Kamenicës, Komunën e Vitisë, Regjionin e Zhupës, Komunën e Novobërdës, Komunën e Ranillikut dhe së fundi në Komunën e Partesh-it. Gjithashtu gjatë ditëve të ndërrimit të lokacionit të mamografit, deri në pregaditje të lokacionit, shërbimi i mamografisë mobile është ofruar dhe në Prishtinë.

Gjatë periudhës gjashtëmuajore Janar-Qershor janë regjistruar 99 ditë pune me mamograf mobil dhe janë ekzaminuar 994 femra (mesatarisht 10 pacientë në ditë pune). 130 pacient janë ekzaminuar ne QKUK dhe 864 ne terren.

Janar	74 femra
Shkurt	119 femra (56 ne QKUK dhe 63 ne terren – Zheger/Gjilan)
Mars	173 femra
Prill	244 femra
Maj	206 femra
Qershor	178 femra

Vërehet rritje e vazhdueshme e kapaciteteve të punës dhe si objektiv është të realizohen 15 ekzaminime në ditë qe paraqet 10% të kërkesave të screening mamografisë.



Për realizimin e punës janë angazhuar stafi i QKUK-së i përbërë nga 6 radiolog, 4 teknik të radiologjisë, 2 inxhinjer, 1 shofer.

Për komunat Gjilan, Kamenicë, Viti është angazhuar stafi i SR të Gjilanit (radiologët dhe teknikët e radiologjisë), ndërsa gjatë operimit të mamografit mobil në regjionin e Zhupës është angazhuar stafi i radiologëve nga SR i Prizrenit.

Në komunat Novobërdë, Ranilluk dhe Partesh ekzaminimet mamografike janë interpretuar nga Radiologët e Klinikës së Radiologjisë në QKUK.

Stafi i Mamografisë mobile deri me 30 Qershor, ka rrugëtuar rreth 10000km.

Problemet teknike për shkak të tensionit të rrymës (sipas Servisit të Autorizuar) nëpër fshatrat e regjionit të Gjilanit: Dobërçan, Përlepticë, komunat e vogla: Ranillugë dhe Partesh kanë shkaktuar ndërprerje të shkurta të punës (2-3 ditë);